



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/191

Datë: 18.06.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15. paragrafi 4. të Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare për vitin 2015.
2. Agjencia e Statistikave e Kosovës është e obliguar që pjesën e implikimeve financiare të këtij plani ta harmonizoj me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës të vitit 2015.
3. Obligohet Agjencia e Statistikave e Kosovës, për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/191
Datë: 18.06.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 66 dhe 67 të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2014, mori:

V E N D I M

Për përcaktimin e zonave të mbrojtura ujore dhe masat e tyre mbrojtëse të burimeve ujore nëntokësore që përdoren për pije - "Puset e Jarinës" në Komunën e Klinës

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Vendimi është, që :
 - 1.1. të mbrojnë burimin ujor nëntokësor - "Puset e Jarinës" në Komunën e Klinës, nga ndikimet negative, të cilat mund ta dëmtojnë gjendjen normale dhe të qëndrueshme të ujit nga aspekti i cilësisë dhe sasisë;
 - 1.2. të sigurojë zhvillimi dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve të ujit për pije nga burimi ujor nëntokësor - "Puset e Jarinës" në Komunën e Klinës, i cili është i domosdoshëm për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social- ekonomik të Kosovës;
 - 1.3. të përcaktojë zonat e mbrojtjes së burimit ujor nëntokësor - "Puset e Jarinës" në Komunën e Klinës si dhe masat e tyre mbrojtëse sipas Ligjit në fuqi.
2. Politikat e mbrojtjes së ujërave bazohen edhe në rritjen e nivelit të mbrojtjes së resursit ujor.
3. Ky Vendim ka për bazë rezultatet e kontrollit të posaçëm dhe studimit kryesor para ndërtimit të burimit ujor, sipas nenit 38, të Udhëzimit Administrativ

“Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Ujore dhe Masat e tyre Mbrojtëse për Burimet e Ujit që Përdoren për Pije” (Nr. 40/07).

Neni 2

Burimi ujqor nëntokësor - “Puset e Jarines” në Komunën e Klinës i përket llojit të burimit ujqor nëntokësor - burim në aquifer karstik.

Neni 3

Mbrojtja e burimit ujqor nëntokësor - “Puset e Jarines” në Komunën e Klinës, është me interes publik dhe personat juridikë ose fizikë kanë përparësi në masat dhe procedurat që ndërmerren në zonën e mbrojtur të burimit ujqor nëntokësor - “Puset e Jarines” në Komunën e Klinës.

Neni 4

Zonat e mbrojtura përfshijnë hapësirën nga burimi karstik deri te ujëndarësi hidrogeologjik i burimit, si dhe objektet me pajisjet për marrjen e ujit.

Neni 5

Kur rrezikohen kushtet cilësore në zonat e mbrojtura ujqore, sipas ligjeve në fuqi, Direktivës 91/676/EEC, dhe Kodit për Praktika të Mira Bujqësore, shpallet zonë e rrezikuar dhe mund të ndalohen ose kufizohen aktivitetet e pronarëve të tokave.

Neni 6

1. Zonat e mbrojtura të burimit ujqor nëntokësor - “Puset e Jarines” në Komunën e Klinës, ndahen në:
 - 1.1. zona e I-rë mbrojtëse;
 - 1.2. zona e II-të mbrojtëse;
 - 1.3. zona e III-të mbrojtëse .

Neni 7

Mbikëqyrja

Mbikëqyrjen e zonave të mbrojtura dhe zbatimin e masave mbrojtëse, do ta bëjë Ministria.

Neni 8

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Shtojca - harta topografike në përpjesëtim 1:25000, ku janë të paraqitura hapësirat e zonave të mbrojtura ujqore me kufijtë e tyre, të shënuar dhe të arkivuar në Ministri/Departamenti i Ujërave/.

Neni 9

1. KRU “HIDRODRINI” - Pejë, është përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi dhe mirëmbajtjen e zonës së I-rë dhe të II-të, rreth burimit ujqor nëntokësor - “Puset e Jarines” në Komunën e Klinës.

2. KRU "HIDRODRINI"- Pejë harton Raportin vjetor për Ministrinë.

Neni 10

Zona e I-rë - zonë e mbrojtjes së regjimit të rreptë

1. Zona e I-rë mbrojtëse përfshin hapësirën, vijën e cila duhet të jetë e larguar më së paku 10m, deri te objekti për marrjen e ujit, me kusht që të vërtetohet se burimi karstik nuk do të jetë i rrezikuar dhe nën monitorim të detyruar të cilësisë së ujit dhe aktiviteteve;
2. Në zonën e I-rë mbrojtëse do të rrethohen: objektet për marrjen e ujit, stacionet e pompimit, trafostacionet, objektet administrative, rrugët hyrëse dhe ato të brendshme si dhe objektet tjera të cilat janë të rëndësishme për punën e objektit për furnizim me ujë;
3. Në territorin e zonës së I-rë mbrojtëse ndalohen të gjitha aktivitetet të cilat nuk janë direkt të lidhura me punën dhe mirëmbajtjen e sistemit për furnizim me ujë. Aktivitetet të cilat bëhen me qëllim të punës dhe mirëmbajtjes së sistemit për furnizim me ujë, nuk duhet të ndikojnë negativisht në burimin ujor;
4. Përjashtimisht nga paragrafi 3, i këtij neni, lejohen aktivitetet si vijon:
 - 4.1. kultivimi i barit pa përdorimin e plehrave dhe preparateve tjera kimike;
 - 4.2. shtrirja e kanalizimit dhe instalimeve tjera, të cilat shërbejnë për punën e objekteve për furnizim me ujë, me ç'rast me projektin përkatës dhe zgjidhjet ekzekutuese duhet të sigurohet që ato instalime të mos e rrezikojnë burimin ujor nëntokësor.

Neni 11

Zona e II-të - zonë e mbrojtjes së regjimit të kufizuar

1. Zona e II-të mbrojtëse përfshin hapësirën nga kufiri i jashtëm i zonës së I-rë mbrojtëse deri te kufiri i jashtëm i zonës së II-të mbrojtëse, duke monitoruar burimin karstik.
2. Kufiri i jashtëm i zonës së II-të mbrojtëse për burimet karstike paraqet vijën prej së cilës, ujërave nëntokësorë i nevojiten më së paku 4 ditë për të arritur deri te hyrja në objektin për marrjen e ujit, me këtë rast ky kufi nuk guxon të jetë më afër se 1000 m, nga objekti për marrjen e ujit.
3. Në territorin e zonës së II-të mbrojtëse të burimit karstik, është e ndaluar ndërtimi i objekteve dhe kryerja e aktiviteteve me të cilat mund të vijë deri te ndotja e burimeve ujore, e veçanërisht:
 - 3.1. ndërtimi i vendbanimeve të reja dhe ndërtimi i kanalizimeve, përveç nëse kjo veprimtari është e kontrolluar dhe e siguruar;
 - 3.2. ndërtimi i objekteve sportive dhe rekreative pa kanalizim jo ujë lëshues;

- 3.3. ndërtimi dhe eksploatimi i burimeve dhe puseve të cilat nuk shfrytëzohen për furnizim publik;
- 3.4. grumbullimi dhe deponimi i të gjitha llojeve të mbeturinave;
- 3.5. ndërtimi dhe puna e stacioneve hekurudhore, të autobusëve dhe terminaleve, nëse nuk janë ndërmarrë masa të posaçme me të cilat pengohet ndotja e burimit ujor nëntokësor;
- 3.6. ndërtimi dhe përdorimi i depove të materieve të rrezikshme për ujin;
- 3.7. gërmimet në akuifer, përveç në periudhë të shkurtër dhe nën kontrollin e cilësisë së ujërave nëntokësorë;
- 3.8. ndërtimi i fermave të kafshëve dhe shpezëve, përveç rritjes deri në 10 krerë bagëti të mëdha dhe shpezë në amvisëritë individuale për nevoja personale, nëse ka të ndërtuar dhe mirë në funksion kanalizimin jo ujëlëshues, gjegjësisht gropën septike jo ujë përshkuese;
- 3.9. transportimi rrugor i kemikaljeve, lëndëve djegëse të lëngëta, vajrave dhe materieve tjera të rrezikshme sipas ligjeve në fuqi;
- 3.10. mihja dhe aktivitete ndërtimi që do të dobësonin shtresat gjeologjike mbrojtëse;
- 3.11. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura në akuifer, si dhe ujërave të ndotura të pa trajtuara në tokë, përfshirë edhe zbrazjen e automjeteve për pastrimin dhe bartjen e fekaleve;
- 3.12. ndërtimi dhe puna e reparteve industriale dhe aktiviteteve të cilat mund të lëshojnë materie të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin;
- 3.13. ndërtimi dhe puna e pajisjeve për pastrimin e ujërave të ndotura dhe pajisjeve për ndezjen e mbeturinave të ngurta;
- 3.14. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura të trajtuara në tokë;
- 3.15. ndërtimi dhe eksploatimi i gyp sjellësit për transportin e kemikateve, lëndëve djegëse të lëngëta, vajrave dhe lëngjeve tjera të rrezikshme, nëse nuk janë ndërmarrë masa të posaçme me të cilat pengohet infiltrimi i këtyre lëngjeve në ujërat nëntokësorë;
- 3.16. kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz dhe materie tjera të rrezikshme, si dhe për ujërat minerale, nëse nuk janë ndërmarrë masa të veçanta me të cilat pengohet infiltrimi ose rrjedhja e këtyre materieve në ujërat nëntokësorë;
- 3.17. deponimi i hapur dhe përdorimi i preparateve kimike të rrezikshme për ujin, të cilat shfrytëzohen për mbrojtjen dhe rritjen e bimëve dhe për shkatërrimin e barojave;

- 3.18. ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i atyre ekzistuese;
- 3.19. eksploatimi i lëndëve minerale, përveç nëse vërtetohet që me atë aktivitet nuk rrezikohet kualiteti i ujit nëntokësor në burim; dhe
- 3.20. aktivitetet tjera për të cilat vërtetohet se mund të kenë pasoja negative për kompleksin e burimeve ujore nëntokësore.

Neni 12

Zona e III-të mbrojtëse - zona e mbrojtjes e regjimit të lehtë

1. Territori i zonës së III-të mbrojtëse përfshinë hapësirën nga kufiri i jashtëm i zonës së II-të mbrojtëse të burimit ujqor nëntokësor karstik, deri te ujëndarësi hidrogeologjik i burimit ujqor nëntokësor, të përcaktuar në kushtet e eksploatimit të burimit ujqor.
 - 2.1. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura të pa trajtuara në tokë, përfshirë edhe zbrazjen e automjeteve për pastrimin dhe bartjen e fekaleve;
 - 2.2. ndërtimi dhe puna e reparteve industriale dhe aktiviteve të cilat mund të lëshojnë materie të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin;
 - 2.3. transporti rrugor i materieve të rrezikshme sipas Ligjit në fuqi;
 - 2.4. ndërtimi dhe puna e pajisjeve për pastrimin e ujërave të ndotura dhe pajisjeve për ndezjen e mbeturinave të ngurta;
 - 2.5. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura të trajtuara në tokë;
 - 2.6. ndërtimi dhe eksploatimi i gyp sjellësit për transportin e kemikateve, lëndëve djegëse të lëngëta, vajrave dhe lëngjeve tjera të rrezikshme, nëse nuk janë ndërmarrë masa të posaçme me të cilat pengohet infiltrimi i këtyre lëngjeve në ujërat nëntokësorë;
 - 2.7. kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz dhe materie tjera të rrezikshme, si dhe për ujëra minerale, nëse nuk janë ndërmarrë masa të veçanta me të cilat pengohet infiltrimi ose rrjedhja e këtyre materieve në ujërat nëntokësorë;
 - 2.8. deponimi i hapur dhe përdorimi i preparateve kimike të rrezikshme për ujin të cilat shfrytëzohen për mbrojtjen dhe rritjen e bimëve dhe për shkatërrimin e barojave të dëmshme;

- 2.9. ndërtimi dhe puna e fermave të kafshëve dhe shpezëve, nëse nuk janë ndërmarrë masa të veçanta me të cilat pengohet ndotja e ujërave nëntokësorë;
- 2.10. eksploatimi i gurit dhe zhavorit, përveç prej gurthyesve dhe seperacioneve, veçanërisht të kontrolluara dhe të mbrojtura dhe nëse vërtetohet që me atë aktivitet nuk rrezikohet kualiteti i ujit nëntokësor në burim;
- 2.11. aktivitetet e ekonomive familjare dhe aktivitetet tjera me të cilat shkatërrohet regjimi natyror i furnizimit të burimit të ujërave nëntokësorë, nëse me masa të veçanta nuk sigurohet furnizimi artificial në sasi të mjaftueshme për kompensimin e sasisë së humbur;
- 2.12. deponimi i të gjitha llojeve të mbeturinave të ngurta jashtë depove sanitare, si edhe në depot sanitare, përveç në rastet kur ato ndodhen në rajonet të cilat formojnë formacione hidrogeologjike të pa përshkueshme;
- 2.13. ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i atyre ekzistuese, përveç kur ndodhen në rajonet të cilat ndërtojnë formacione hidrogeologjike të pa përshkueshme;
- 2.14. prerja e pyjeve, ndërtimi i rrugëve, ekzekutimi i gërmimeve tokësore dhe aktivitetet tjera të cilat nxisin ose përshpejtojnë erozionin;
- 2.15. aktivitetet tjera për të cilat vërtetohet se mund të kenë pasoja negative për burimin ujqor.

Neni 13

Masat mbrojtëse në zonën e I-rë dhe të II-të

1. Vendosja e sistemit efikas të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të mbeturinave;
2. Vendosja e sistemi efikas për monitorimin e burimit ujqor nëntokësor - "Puset e Jarines" në Komunën e Klinës;
 - 2.1. Si masë afat shkurtër të bëhet monitorim i posaçëm në zonën e I-rë të burimit ujqor nëntokësor - "Puset e Jarines" në Komunën e Klinës;
 - 2.2. Si masë afatgjatë të bëhen investime të mëtejme në impiantin e më parshëm të trajtimit të ujit për pije që vjen nga Puset e Jarines, deri në arritjen e rezultateve të duhura të cilësisë së ujit sipas standardeve në fuqi;
 - 2.3. Si masë afatgjatë të bëhet mbrojtja e përhershme e burimit ujqor nëntokësor - "Puset e Jarines" në Komunën e Klinës nga përmbytjet;
3. Për t'u pajisur me Pëlqim Mjedisor sipas nenit 7, të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, ose me Autorizim Mjedisor nga Ministria, sipas nenit 33, të Ligjit Për Mbrojtjen e Mjedisit, procedurës administrative i nënshtrohen:
 - 3.1. Ndërtimet e objekteve të reja sipas Ligjit për Ndërtim, Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe akteve tjera nënligjore në fuqi;

- 3.2. Ndërtimet pa leje, që nënkupton objektet e ndërtuara në kundërshtim me dispozitat dhe procedurat e përcaktuara sipas Ligjit për Ndërtim dhe akteve tjera ligjore në fuqi;
- 3.3. Investimet dhe zhvillimet e projekteve me potencial ndotës të burimit të ujit;
- 3.4. Objektet afariste të cilat nuk kanë leje për punë.
4. Për objektet ekzistuese të bëhet legalizimi i ndërtimeve pa leje, sipas Ligjeve në fuqi;
5. Investitori, sipas Ligjit në fuqi, nuk mund të marrë leje për ndërtim si dhe nuk mund të fillojë realizimin e ndonjë projekti të planifikuar, pa u pajisur me Pëlqim Mjedisor ose me Autorizim Mjedisor nga MMPH-ja;
6. MMPH-ja, sipas Ligjit në fuqi, lëshon vërtetim për objektet që nuk i nënshtrohen procedurës administrative për t'u pajisur me Pëlqim Mjedisor ose me Autorizim Mjedisor;
7. Për aktivitetet bujqësore që zhvillohen në këto zona të rrezikuara nga ndikimet antropogjene, hartohet programi i masave dhe zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi, Direktivës 91/676/EEC dhe Kodit për Praktika të Mira Bujqësore.
8. Në zonën mbrojtëse të burimit ndalohet transporti i mallrave të rrezikshme sipas nenit 1. të Ligjit Nr. 04/L-183 PËR TRANSPORTIN TOKËSOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME, dhe sipas Konventave ndërkombëtare për transportin e mallrave me hekurudhë (CIM), Konventa për transportin ndërkombëtar hekurudhor (COTIF) dhe Rregullat në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme me hekurudhë-anexi C (RID) .
9. Të vendosen tabelat informative në kufirin e zonës së I-rë dhe II-të mbrojtëse;
10. MMPH-ja harton planin e veprimit për zbatimin e masave mbrojtëse.

Neni 14

Masat mbrojtëse në zonën e III-të

1. Për t'u pajisur me Pëlqim mjedisor ose Autorizim Mjedisor për zonën e III- të mbrojtëse, aplikohen procedurat administrative sipas nenit 13, të këtij Vendimi;
2. Për aktivitetet bujqësore, të zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi, Direktivës 91/676/EEC dhe Kodit për Praktika të Mira Bujqësore.

Neni 15

Vendimi hyn në fuqi datën e shpalljes në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/191
Datë: 18.06.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 66 dhe 67 të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2014, mori:

V E N D I M

Për përcaktimin e zonave të mbrojtura ujore dhe masat e tyre mbrojtëse të burimeve ujore nëntokësore dhe sipërfaqësore që përdoren për pije - "Puset në Klinë dhe kaptimi në lumin Drini i Bardhë" në Komunën e Klinës

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Vendimi është, që:
 - 1.1. të mbrojë burimin uhor nëntokësor dhe sipërfaqësor - "Puset në Klinë dhe kaptimi në lumin Drini i Bardhë", në Komunën e Klinës, nga ndikimet negative, të cilat mund ta dëmtojnë gjendjen normale dhe të qëndrueshme të ujit nga aspekti i cilësisë dhe sasisë;
 - 1.2. të sigurojë zhvillim dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve të ujit për pije nga burimet ujore nëntokësore dhe sipërfaqësore - "Puset në Klinë dhe kaptimi në lumin Drini i Bardhë" në Komunën e Klinës, i cili është i domosdoshëm për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social- ekonomik të Kosovës;
 - 1.3. të përcaktojë zonat e mbrojtjes së burimeve ujore nëntokësore dhe sipërfaqësore - "Puset në Klinë dhe kaptimi në lumin Drini i Bardhë", në Komunën e Klinës si dhe masat e tyre mbrojtëse sipas Ligjit në fuqi.

2. Politikat e mbrojtjes së ujërave bazohen edhe në rritjen e nivelit të mbrojtjes së resursit ujqor.
3. Ky Vendim ka për bazë rezultatet e kontrollit të posaçëm dhe studimit kryesor para ndërtimit të burimit ujqor, sipas nenit 38, të Udhëzimit Administrativ "Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Ujqore dhe Masat e tyre Mbrojtëse për Burimet e Ujqit që Përdoret për Pije" (Nr. 40/07).

Neni 2

Burimet ujqore nëntokësore dhe sipërfaqësore - "Puset në Klinë dhe kaptimi në lumin Drini i Bardhë" në Komunën e Klinës i përkasin llojit të burimeve ujqore nëntokësore - në aquifer intergranular dhe burimeve ujqore sipërfaqësore- në ujë rrjedha të hapura.

Neni 3

Mbrojtja e burimeve ujqore nëntokësore dhe sipërfaqësore - "Puset në Klinë dhe kaptimi në lumin Drini i Bardhë", në Komunën e Klinës, është me interes publik dhe personat juridikë ose fizikë kanë përparësi në masat dhe procedurat që ndërmerren në zonën e mbrojtur të burimeve ujqore nëntokësore dhe sipërfaqësore - "Puset në Klinë dhe kaptimi në lumin Drini i Bardhë" në Komunën e Klinës.

Neni 4

Zonat e mbrojtura përfshijnë hapësirën nga burimi karstik deri te ujëndarësi hidrogeologjik i burimit, si dhe objektet me pajisjet për marrjen e ujqit.

Neni 5

Kur rrezikohen kushtet cilësore në zonat e mbrojtura ujqore, sipas ligjeve në fuqi, Direktivës 91/676/EEC, dhe Kodit për Praktika të Mira Bujqësore, shpallet zonë e rrezikuar dhe mund të ndalohen ose kufizohen aktivitetet e pronarëve të tokave.

Neni 6

1. Zonat e mbrojtura të burimeve ujqore nëntokësore dhe sipërfaqësore - "Puset në Klinë dhe kaptimi në lumin Drini i Bardhë" në Komunën e Klinës, ndahen në:
 - 1.1. zona e I-rë mbrojtëse;
 - 1.2. zona e II-të mbrojtëse;
 - 1.3. zona e III-të mbrojtëse.

Neni 7

Mbikëqyrja

Mbikëqyrjen e zonave të mbrojtura dhe zbatimin e masave mbrojtëse, do ta bëjë Ministria.

Neni 8

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Shtojca - harta topografike në përpjesëtim 1:25000, ku janë të pasqyruara hapësirat e zonave të mbrojtura ujqore me kufijtë e tyre të shënuar dhe të arkivuar në Ministri/Departamenti i Ujqërave/.

Neni 9

1. KRU "HIDRODRINI" - Pejë, është përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi dhe

mirëmbajtjen e zonës së I-rë dhe të II-të, rreth burimeve ujore nëntokësore dhe sipërfaqësore- "Puset në Klinë dhe kaptimi në lumin Drini i Bardhë" në Komunën e Klinës.

2. KRU "HIDRODRINI"- Pejë harton Raportin vjetor për Ministrinë.

Neni 10

Zona e I-rë - zonë e mbrojtjes së regjimit të rreptë

1. Zona e I-rë mbrojtëse përfshin hapësirën, vijën e cila duhet të jetë e larguar më së paku 10m nga objekti për marrjen e ujit;
 - 1.1. Puset në Klinë - me kusht që me punime hulumtuese përkatëse dhe llogaritje të argumentohet që nuk do të vjen deri te ndotja bakteriologjike e ujit nga pusi;
 - 1.2. Kaptimi në lumin Drini i Bardhë- si edhe pjesën e njëres apo të dy brigjeve të ujë-rrjedhës, me zonën e I-rë mbrojtëse duhet të përfshihet edhe brezi kufitar i bregut në njëren apo në të dy anët e ujë-rrjedhës me gjerësi më së paku 10m. nga bregu, e matur nga niveli maksimal i ujërave;
2. Në zonën e I-rë mbrojtëse do të rrethohen: objektet për marrjen e ujit, rezervuarët, stacionet e pompimit, trafostacionet, objektet administrative, rrugët hyrëse dhe ato të brendshme si dhe objektet tjera të cilat janë të rëndësishme për punën e objektit për furnizim me ujë;
3. Në territorin e zonës së I-rë mbrojtëse ndalohen të gjitha aktivitetet të cilat nuk janë direkt të lidhura me punën dhe mirëmbajtjen e sistemit për furnizim me ujë. Aktivitetet të cilat bëhen me qëllim të punës dhe mirëmbajtjes së sistemit për furnizim me ujë, nuk duhet të ndikojnë negativisht në burimin ujqor;
4. Përjashtimisht nga paragrafi 3, i këtij neni, lejohen aktivitetet si vijon:
 - 4.1. kultivimi i barit pa përdorimin e plehrave dhe preparateve tjera kimike;
 - 4.2. shtrirja e kanalizimit dhe instalimeve tjera, të cilat shërbejnë për punën e objekteve për furnizim me ujë, me ç 'rast me projektin përkatës dhe zgjidhjet ekzekutuese duhet të sigurohet që ato instalime të mos e rrezikojnë burimin ujqor nëntokësor.

Neni 11

Zona e II-të - zonë e mbrojtjes së regjimit të kufizuar

1. Zona e II-të mbrojtëse përfshin:
 - 1.1. Puset në Klinë- hapësirën nga kufiri i jashtëm i zonës së I-rë mbrojtëse deri te vija prej së cilës ujit nëntokësor i nevojitet më së paku 50 ditë për arritje deri në objektin për marrjen e ujit;
 - 1.2. Kaptimi në lumin Drini i Bardhë- pjesa e ujë-rrjedhës; në drejtim të kundërt të rrjedhës, e përcaktuar në bazë të kohës së rrjedhjes së ujit prej 3 (tre) orëve, kurse në drejtim të rrjedhës, e përcaktuar në bazë të kohës së

rrjedhjes prej 10 minutave.

2. Kaptimi në lumin Drini i Bardhë - Territori i zonës së II-të mbrojtëse përfshinë edhe brezin kufitar të brigjeve në të dy anët e ujë-rrjedhës me gjerësi më së paku 300m, e matur nga bregu i ujë-rrjedhës i përcaktuar gjatë nivelit maksimal të ujërave.
3. Në territorin e zonës së II-të mbrojtëse të burimit në akuifer intergranular dhe sipërfaqësor-ujërrjedha të hapura, është e ndaluar ndërtimi i objekteve dhe kryerja e aktiviteteve me të cilat mund të vijë deri te ndotja e burimeve ujore, e veçanërisht:
 - 3.1. ndërtimi i vendbanimeve të reja dhe ndërtimi i kanalizimeve, përveç nëse jo ujë lëshueshmëria e gypave të kanalizimit është e kontrolluar dhe e siguruar;
 - 3.2. ndërtimi i objekteve sportive dhe rekreative pa kanalizim jo ujë lëshues si dhe aktivitetet sportive dhe rekreative, përveç kur nuk rrezikohet cilësia e ujit në burim, si dhe përdorimi i mjeteve lundruese me motor me djegie të brendshme;
 - 3.3. eksploatimi i lëndëve minerale, përveç nëse vërtetohet që me atë aktivitet nuk rrezikohet kualiteti i ujit nëntokësor në burim;
 - 3.4. ndërtimi dhe eksploatimi i burimeve dhe puseve të cilat nuk shfrytëzohen për furnizim publik;
 - 3.5. gërmimet në akuifer, përveç në periudhë të shkurtër dhe nën kontrollin e cilësisë së ujërave nëntokësorë;
 - 3.6. grumbullimi dhe deponimi i të gjitha llojeve të mbeturinave;
 - 3.7. ndërtimi dhe puna e reparteve industriale dhe zejeve të cilat mund të lëshojnë materie të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin;
 - 3.8. ndërtimi dhe puna e stacioneve hekurudhore, të autobusëve dhe terminaleve, nëse nuk janë ndërmarrë masa të posaçme me të cilat pengohet ndotja e burimit ujqor nëntokësor;
 - 3.9. ndërtimi dhe përdorimi i depove të materieve të rrezikshme për ujin;
 - 3.10. ndërtimi dhe puna e fermave të kafshëve dhe shpezëve, përveç rritjes deri në 10 krerë bagëti të mëdha dhe shpezë në amvisëritë individuale për nevoja personale, nëse ka të ndërtuar dhe mirë në funksion kanalizimin jo ujëlëshues, gjegjësisht gropën septike jo ujë përshkuese me të cilat pengohet ndotja e burimeve (puseve dhe ujë rrjedhës);
 - 3.11. ndërtimi dhe eksploatimi i gyp sjellësit për transportin e kemikateve, lëndëve djegëse të lëngëta, vajrave dhe lëngjeve tjera të rrezikshme, nëse nuk janë ndërmarrë masa të posaçme me të cilat pengohet infiltrimi i këtyre lëngjeve në ujërat nëntokësorë dhe ujë-rrjedha;
 - 3.12. transportimi rrugor i kemikaljeve, lëndëve djegëse të lëngëta, vajrave dhe

materieve tjera të rrezikshme sipas ligjeve në fuqi;

- 3.13. kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz dhe materie tjera të rrezikshme, si dhe për ujërat minerale, nëse nuk janë ndërmarrë masa të veçanta me të cilat pengohet infiltrimi ose rrjedhja e këtyre materieve në ujërat nëntokësorë-ujë-rrjedha;
- 3.14. eksploatimi i lëndës së parë minerale dhe zhavorit;
- 3.15. mihja dhe aktivitete ndërtimi që do të dobësonin shtresat gjeologjike mbrojtëse;
- 3.16. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura në akuifer dhe ujë-rrjedha të hapura mbi objektin e marrjes së ujit, ujërave të ndotura të pa trajtuara në tokë, përfshirë edhe zbrazjen e automjeteve për pastrimin dhe bartjen e fekaleve;
- 3.17. ndërtimi dhe puna e pajisjeve për pastrimin e ujërave të ndotura dhe pajisjeve për ndezjen e mbeturinave të ngurta;
- 3.18. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura të trajtuara në tokë;
- 3.19. deponimi i hapur dhe përdorimi i preparateve kimike të rrezikshme për ujin, të cilat shfrytëzohen për mbrojtjen dhe rritjen e bimëve dhe për shkatërrimin e barojave.
- 3.20. ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i atyre ekzistuese;
- 3.21. aktivitetet e ekonomive familjare dhe aktivitetet tjera me të cilat shkatërrohet regjimi natyror i ujë rrjedhës në vendin e marrjes së ujit në atë masë me të cilën rrezikohet kapaciteti i burimit;
- 3.22. deponimi i të gjitha llojeve të mbeturinave të ngurta jashtë deponimeve sanitare, si dhe në deponimet sanitare nëse nuk është siguruar largimi i filtratit nga deponimi sanitar jashtë territorit të pellgut të objektit për marrjen e ujit;
- 3.23. prerja e pyjeve, ndërtimi i rrugëve, ekzekutimi i gropimeve të mëdha tokësore dhe aktivitetet tjera të cilat nxisin ose përshpejtojnë erozionin e tokës;
- 3.24. kultivimi komercial i peshkut përveç rritjes biologjike dhe ripërtëritjes së tyre;
- 3.25. aktivitetet tjera për të cilat vërtetohet se mund të kenë pasoja negative për kompleksin e burimeve ujore nëntokësore - në akuifer intergranular dhe sipërfaqësor - në ujë rrjedha të hapura.

Neni 12

Zona e III-të mbrojtëse - zona e mbrojtjes së regjimit të lehtë

1. Territori i zonës së III-të mbrojtëse përfshinë hapësirën:
 - 1.1. Puset në Klinë - nga kufiri i jashtëm i zonës së II-të mbrojtëse deri te ujëndarësi hidro gjeologjik, të përcaktuar në kushtet e eksploatimit të burimit ujqor që paraqet kufirin e jashtëm të zonës së III-të mbrojtëse.
 - 1.2. Kaptimi në lumin Drini i Bardhë - nga kufiri i jashtëm i zonës së II-të mbrojtëse të burimit ujqor sipërfaqësor, deri te kufiri-ujëndarësi i pellgut orografik përkatës për burimin e ujqit.
2. Në territorin e zonës së III-të mbrojtëse të burimit ujqor sipërfaqësor – ujë rrjedha të hapura, është i ndaluar ndërtimi i objekteve dhe kryerja e aktiviteteve me të cilat mund të vijë deri te ndotja e ujqit të burimit, e veçanërisht:
 - 2.1. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura në aquifer dhe në ujë rrjedha mbi objektin e marrjes së ujqit dhe shkarkimi në tokë i ujërave të ndotura të trajtuara e të pa trajtuara, përfshirë edhe zbrazen dhe pastrimin e automjeteve për transportimin e fekaleve;
 - 2.2. ndërtimi dhe puna e reparteve industriale dhe aktiviteteve të cilat mund të lëshojnë materie të dëmshme dhe të rrezikshme për ujqin;
 - 2.3. transporti rrugor i materieve të rrezikshme sipas Ligjit në fuqi;
 - 2.4. ndërtimi dhe puna e pajisjeve për pastrimin e ujërave të ndotura dhe pajisjeve për ndezjen e mbeturinave të ngurta;
 - 2.5. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura të trajtuara në tokë;
 - 2.6. ndërtimi dhe eksploatimi i gyp sjellësit për transportimin e kemikateve, lëndëve djegëse të lëngëta, vajrave dhe lëngjeve tjera të rrezikshme, nëse nuk janë ndërmarrë masa të posaçme me të cilat pengohet depërtimin-infiltrimi i këtyre lëngjeve në ujërat nëntokësorë dhe ujërrjedha;
 - 2.7. kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz dhe materie tjera të rrezikshme, si dhe për ujërat minerale, nëse nuk janë ndërmarrë masa të veçanta me të cilat pengohet infiltrimi ose rrjedhja e këtyre materieve në ujërat nëntokësorë dhe sipërfaqësorë;
 - 2.8. aktivitetet e ekonomive familjare dhe aktivitetet tjera me të cilat shkatërrohet regjimi natyror i ujë rrjedhës në vendin e marrjes së ujqit në atë masë me të cilën rrezikohet kapaciteti i burimit;
 - 2.9. deponimi i të gjitha llojeve të mbeturinave të ngurta jashtë deponimeve sanitare, si dhe në deponimet sanitare nëse nuk është siguruar largimi i filtratit nga deponimi sanitar jashtë territorit të pellgut të objektit për marrjen e ujqit;

- 2.10. deponimi i hapur dhe përdorimi i preparateve kimike të rrezikshme për ujin të cilat shfrytëzohen për mbrojtjen dhe rritjen e bimëve dhe për shkatërrimin e barojave.
- 2.11. ndërtimi dhe puna e fermave të kafshëve dhe shpezëve, nëse nuk janë ndërmarrë masa të veçanta me të cilat pengohet ndotja e ujërave nëntokësore dhe të ujë rrjedhës;
- 2.12. eksploatimi i resurseve minerale, përveç nëse vërtetohet që me atë aktivitet nuk rrezikohet kualiteti i ujit nëntokësor dhe sipërfaqësor në burim;
- 2.13. eksploatimi i gurëve dhe zhavorit, përveç nga gurëthyesit dhe seperacionet e mbrojtura dhe të kontrolluara;
- 2.14. prerja e pyjeve, ndërtimi i rrugëve, ekzekutimi i gropimeve të mëdha tokësore dhe aktivitetet tjera të cilat nxisin ose përshpejtojnë erozionin e tokës;
- 2.15. kultivimi komercial i peshkut përveç rritjes biologjike dhe ripërtëritjes së tyre;
- 2.16. përdorimi i mjeteve lundruese me motor me djegie të brendshme;
- 2.17. ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i atyre ekzistuese;
- 2.18. aktivitetet tjera për të cilat vërtetohet se mund të kenë pasoja negative për burimin ujor.

Neni 13

Masat mbrojtëse në zonën e I-rë dhe të II-të

1. Vendosja e sistemit efikas të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të mbeturinave;
2. Vendosja e sistemi efikas për monitorimin e burimit ujor nëntokësor - "Puset e Jarines" në Komunën e Klinës;
 - 2.1. Si masë afat shkurtër të bëhet monitorim i posaçëm në zonën e I-rë të burimit ujor nëntokësor dhe sipërfaqësor - "Puset në Klinë dhe kaptimi në lumin Drini i Bardhë" në Komunën e Klinës;
 - 2.2. Ndalohet rreptësisht marrja e ujit mbi kaptazhë-vepra e marrjes së ujit nga ujërrjedha dhe marrja e masave efikase për eliminimin e keqpërdorimit të ujit;
 - 2.3. Sigurimi i prurjes minimale të lumit Drini i Bardhë sipas Ligjit 04/L-147, për Ujërat e Kosovës;
 - 2.4. Si masë afatgjatë të bëhet mbrojtja e përhershme e burimit ujor nëntokësor dhe sipërfaqësor - "Puset në Klinë dhe kaptimi në lumin Drini i Bardhë" në Klinë, në Komunën e Klinës nga përmblytjet;
3. Për t'u pajisur me Pëlqim Mjedisor sipas nenit 7, të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, ose me Autorizim Mjedisor nga Ministria, sipas nenit 33, të Ligjit Për Mbrojtjen e Mjedisit , procedurës administrative i nënshtrohen:

- 3.1. Ndërtimet e objekteve të reja sipas Ligjit për Ndërtim, Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe akteve tjera ligjore në fuqi;
 - 3.2. Ndërtimet pa leje, që nënkupton objektet e ndërtuara në kundërshtim me dispozitat dhe procedurat e përcaktuara sipas Ligjit për Ndërtim dhe akteve tjera ligjore në fuqi;
 - 3.3. Investimet dhe zhvillimet e projekteve me potencial ndotës të burimit të ujit;
 - 3.4. Objektet afariste të cilat nuk kanë leje për punë.
4. Për objektet ekzistuese të bëhet legalizimi i ndërtimeve pa leje, sipas Ligjeve në fuqi;
 5. Investitori, sipas Ligjit në fuqi, nuk mund të marrë leje për ndërtim si dhe nuk mund të fillojë realizimin e ndonjë projekti të planifikuar, pa u pajisur me Pëlqim Mjedisor ose me Autorizim Mjedisor nga MMPH-ja;
 6. MMPH-ja, sipas Ligjit në fuqi, lëshon vërtetim për objektet që nuk i nënshtrohen procedurës administrative për t'u pajisur me Pëlqim Mjedisor ose me Autorizim Mjedisor;
 7. MMPH-ja harton planin e veprimit për zbatimin e masave mbrojtëse;
 8. Për aktivitetet bujqësore që zhvillohen në këto zona të rrezikuara nga ndikimet antropogjene, hartohet programi i masave dhe zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi, Direktivës 91/676/EEC dhe Kodit për Praktika të Mira Bujqësore.
 9. Në zonën mbrojtëse të burimit ndalohet transporti i mallrave të rrezikshme sipas nenit 1. të Ligjit Nr. 04/L-183 PËR TRANSPORTIN TOKËSOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHMË, dhe sipas Konventave ndërkombëtare për transportin e mallrave me hekurudhë (CIM), Konventa për transportin ndërkombëtar hekurudhor (COTIF) dhe Rregullat në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme me hekurudhë-anexi C (RID) .
 10. Të vendosen tabelat informative në kufirin e zonës së I-rë dhe II-të mbrojtëse.

Neni 14

Masat mbrojtëse në zonën e III-të

1. Për t'u pajisur me Pëlqim mjedisor ose Autorizim Mjedisor për zonën e III- të mbrojtëse, aplikohen procedurat administrative sipas nenit 13, të këtij Vendimi;
2. Për aktivitetet bujqësore, të zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi, Direktivës 91/676/EEC dhe Kodit për Praktika të Mira Bujqësore.

Neni 15

Vendimi hyn në fuqi datën e shpalljes në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/191
Datë: 18.06.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 66 dhe 67 të Ligjit 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2014, mori:

V E N D I M

Për përcaktimin e zonave të mbrojtura ujore dhe masat e tyre mbrojtëse të burimeve ujore nëntokësore që përdoren për pije - "Lagje Fidanishte 1,2,3-Topallnica 1,2,3" në Suharekë, Komuna e Suharekës

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Vendimi është, që :
 - 1.1. të mbrojë burimet ujore nëntokësore - "Lagje Fidanishte 1,2,3 - Topallnica 1,2,3" në Suharekë, Komuna e Suharekës, nga ndikimet negative, të cilat mund ta dëmtojnë gjendjen normale dhe të qëndrueshme të ujit nga aspekti i cilësisë dhe sasisë;
 - 1.2. të sigurojë zhvillim dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve të ujit për pije nga burimet ujore nëntokësore - "Lagje Fidanishte 1,2,3-Topallnica 1,2,3" në Suharekë, Komuna e Suharekës, i cili është i domosdoshëm për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social- ekonomik të Kosovës;
 - 1.3. të përcaktojë zonat e mbrojtjes së burimeve ujore nëntokësore - "Lagje Fidanishte 1,2,3-Topallnica 1,2,3" në Suharekë, Komuna e Suharekës, si dhe masat e tyre mbrojtëse sipas Ligjit në fuqi.

2. Politikat e mbrojtjes së ujërave bazohen edhe në rritjen e nivelit të mbrojtjes së resursit ujor.
3. Ky Vendim ka për bazë rezultatet e kontrollit të posaçëm dhe studimit kryesor para ndërtimit të burimit ujor sipas nenit 38, të Udhëzimit Administrativ "Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Ujore dhe Masat e tyre Mbrojtëse për Burimet e Ujore që Përdoren për Pije" (Nr. 40/07).

Neni 2

Burimet ujore nëntokësore - "Lagje Fidanishte 1,2,3-Topallnica 1,2,3" në Suharekë, Komuna e Suharekës, i përkasin llojit të burimit ujor nëntokësor - burim në aquifer intergranular.

Neni 3

Mbrojtja e burimeve ujore nëntokësore "Lagje Fidanishte 1,2,3-Topallnica 1,2,3" në Suharekë, Komuna e Suharekës, është me interes publik dhe personat juridikë ose fizikë kanë përparësi në masat dhe procedurat që ndërmerren në zonën e mbrojtur të burimeve ujore nëntokësore - "Lagje Fidanishte 1,2,3-Topallnica 1,2,3" në Suharekë, Komuna e Suharekës.

Neni 4

Zonat e mbrojtura përfshijnë hapësirën nga burimi intergranular deri te ujëndarësi hidro-gjeologjik i burimit, si dhe objektet me pajisjet për marrjen e ujërave.

Neni 5

Kur rrezikohen kushtet cilësore në zonat e mbrojtura ujore, sipas ligjeve në fuqi, Direktivës 91/676/EEC, dhe Kodit për Praktika të Mira Bujqësore, shpallet zonë e rrezikuar dhe mund të ndalohen ose kufizohen aktivitetet e pronarëve të tokave.

Neni 6

1. Zonat e mbrojtura të burimeve ujore nëntokësore - "Lagje Fidanishte 1,2,3-Topallnica 1,2,3" në Suharekë, Komuna e Suharekës, ndahen në:
 - 1.1. zona e I-rë mbrojtëse;
 - 1.2. zona e II-të mbrojtëse;
 - 1.3. zona e III-të mbrojtëse .

Neni 7

Mbikëqyrja

Mbikëqyrjen e zonave të mbrojtura dhe zbatimin e masave mbrojtëse, do ta bëjë Ministria.

Neni 8

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Shtojca - harta topografike në përpjesëtim 1:25000, ku janë të paraqitura hapësirat e zonave të mbrojtura ujore me kufijtë e tyre të shënuar dhe të arkivuar në Ministri/Departamenti i Ujërave/.

Neni 9

1. KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" Sha- Prizren, është përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi dhe mirëmbajtjen e zonës së I-rë dhe të II-të, rreth burimeve ujore nëntokësore - " Lagje Fidanishte 1,2,3-Topallnica 1,2,3" në Suharekë, Komuna e Suharekës.
2. KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" Sha- Prizren harton Raportin vjetor për Ministrinë.

Neni 10

Zona e I-rë - zonë e mbrojtjes së regjimit të rreptë

1. Zona e I-rë mbrojtëse përfshin hapësirën, vijën e cila duhet të jetë e larguar më së paku 10m, nga objekti për marrjen e ujit, me kusht që me punime hulumtuese përkatëse dhe llogaritje, të argumentohet që nuk do të vjen deri te ndotja bakteriologjike e ujit;
2. Në zonën e I-rë mbrojtëse do të rrethohen: objektet për marrjen e ujit, rezervuarët, stacionet e pompimit, trafostacionet, objektet administrative, rrugët hyrëse dhe ato të brendshme si dhe objektet tjera të cilat janë të rëndësishme për punën e objektit për furnizim me ujë;
3. Në territorin e zonës së I-rë mbrojtëse ndalohen të gjitha aktivitetet të cilat nuk janë direkt të lidhura me punën dhe mirëmbajtjen e sistemit për furnizim me ujë.

Aktivitetet të cilat bëhen me qëllim të punës dhe mirëmbajtjes së sistemit për furnizim me ujë, nuk duhet të ndikojnë negativisht në burimin ujqor;

4. Përjashtimisht nga paragrafi 3, i këtij neni, lejohen aktivitetet si vijon:
 - 4.1. kultivimi i barit pa përdorimin e plehrave dhe preparateve tjera kimike;
 - 4.2. shtrirja e kanalizimit dhe instalimeve tjera, të cilat shërbejnë për punën e objekteve për furnizim me ujë, me ç'rast me projektin përkatës dhe zgjidhjet ekzekutuese duhet të sigurohet që ato instalime të mos e rrezikojnë burimin ujqor nëntokësor.

Neni 11

Zona e II-të - zonë e mbrojtjes së regjimit të kufizuar

1. Zona e II-të mbrojtëse përfshin hapësirën nga kufiri i jashtëm i zonës së I-rë mbrojtëse deri te vija prej së cilës ujit nëntokësor i nevojitet më së paku 50 ditë për arritje deri në objektin për marrjen e ujit.
2. Në territorin e zonës së II-të mbrojtëse të burimit në aquifer intergranular, është e ndaluar ndërtimi i objekteve dhe kryerja e aktiviteteve të cilat mund të ndotin ujin e burimit, e veçanërisht:
 - 2.1. ndërtimi i vendbanimeve të reja dhe ndërtimi i kanalizimeve, përveç nëse

jo ujë lëshueshmëria e gypave të kanalizimit është e kontrolluar dhe e siguruar;

- 2.2. ndërtimi i objekteve sportive dhe rekreative pa kanalizim jo ujëlëshues;
- 2.3. ndërtimi dhe eksploatimi i burimeve dhe puseve të cilat nuk shfrytëzohen për furnizim publik;
- 2.4. grumbullimi dhe deponimi i të gjitha llojeve të mbeturinave;
- 2.5. ndërtimi dhe puna e stacioneve hekurudhore, të autobusëve dhe terminaleve, nëse nuk janë ndërmarrë masa të posaçme me të cilat pengohet ndotja e burimit ujor nëntokësor;
- 2.6. ndërtimi dhe përdorimi i depove të materieve të rrezikshme për ujin;
- 2.7. gërmimet në akuifer, përveç në periudhë të shkurtër dhe nën kontrollin e cilësisë së ujërave nëntokësorë;
- 2.8. ndërtimi i fermave të kafshëve dhe shpezëve, përveç rritjes deri në 10 krerë bagëti të mëdha dhe shpezë në amvisëritë individuale për nevoja personale, nëse ka të ndërtuar mirë dhe në funksion kanalizimin jo ujëlëshues, gjegjësisht gropën septike jo ujë përshkuese;
- 2.9. transportimi rrugor i kemikaljeve, lëndëve djegëse të lëngëta, vajrave dhe materieve tjera të rrezikshme sipas ligjeve në fuqi;
- 2.10. mihje dhe aktivitete ndërtimi që do të dobësonin shtresat gjeologjike mbrojtëse;
- 2.11. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura në akuifer, si dhe ujërave të ndotura të pa trajtuara në tokë, përfshirë edhe zbrazjen e automjeteve për pastrimin dhe bartjen e fekaleve;
- 2.12. ndërtimi dhe puna e reparteve industriale dhe zanateve të cilat mund të lëshojnë materie të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin;
- 2.13. ndërtimi dhe puna e pajisjeve për pastrimin e ujërave të ndotura dhe pajisjeve për ndezjen e mbeturinave të ngurta;
- 2.14. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura të trajtuara në tokë;
- 2.15. ndërtimi dhe eksploatimi i gyp sjellësit për transportin e kemikateve, lëndëve djegëse të lëngëta, vajrave dhe lëngjeve tjera të rrezikshme, nëse nuk janë ndërmarrë masa të posaçme me të cilat pengohet infiltrimi i këtyre lëngjeve në ujërat nëntokësorë;
- 2.16. kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz dhe materie tjera të rrezikshme, si dhe për ujërat minerale, nëse nuk janë ndërmarrë masa të veçanta me të cilat pengohet infiltrimi ose rrjedhja e këtyre materieve në

ujërat nëntokësorë;

- 2.17. deponimi i hapur dhe përdorimi i preparateve kimike të rrezikshme për ujin, të cilat shfrytëzohen për mbrojtjen dhe rritjen e bimëve dhe për shkatërrimin e barojave të dëmshme;
- 2.18. ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i atyre ekzistuese;
- 2.19. eksploatimi i lëndëve minerale, përveç nëse vërtetohet që me atë aktivitet nuk rrezikohet kualiteti i ujit nëntokësor në burim; dhe
- 2.20. aktivitetet tjera për të cilat vërtetohet se mund të kenë pasoja negative për kompleksin e burimeve ujore nëntokësore.

Neni 12

Zona e III-të mbrojtëse - zona e mbrojtjes e regjimit të lehtë

1. Territori i zonës së III-të mbrojtëse përfshin hapësirën nga kufiri i jashtëm i zonës së II-të mbrojtëse deri te ujëndarësi hidro-gjeologjik, të përcaktuar në kushtet e eksploatimit të burimit ujqor që paraqet kufirin e jashtëm të zonës së III-të mbrojtëse.
2. Në territorin e zonës së III-të mbrojtëse, ndalohet ekzekutimi i punimeve, ndërtimi i objekteve dhe kryerja e aktiviteteve me të cilat mund të ndotin ujin e burimit, e veçanërisht:
 - 2.1. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura të pa trajtuara në aquifer, si dhe ujërave të ndotura të pa trajtuara në tokë, përfshirë edhe zbrazjen e automjeteve për pastrimin dhe bartjen e fekaleve;
 - 2.2. ndërtimi dhe puna e reparteve industriale dhe aktiviteteve të cilat mund të lëshojnë materie të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin;
 - 2.3. transporti rrugor i materieve të rrezikshme sipas Ligjit në fuqi;
 - 2.4. ndërtimi dhe puna e pajisjeve për pastrimin e ujërave të ndotura dhe pajisjeve për ndezjen e mbeturinave të ngurta;
 - 2.5. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura të trajtuara në tokë;
 - 2.6. ndërtimi dhe eksploatimi i gyp sjellësit për transportin e kemikateve, lëndëve djegëse të lëngëta, vajrave dhe lëngjeve tjera të rrezikshme, nëse nuk janë ndërmarrë masa të posaçme me të cilat pengohet infiltrimi i këtyre lëngjeve në ujërat nëntokësorë;
 - 2.7. kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz dhe materie tjera të rrezikshme, si dhe për ujërat minerale, nëse nuk janë ndërmarrë masa të veçanta me të cilat pengohet infiltrimi ose rrjedhja e këtyre materieve në ujërat nëntokësorë;

- 2.8. deponimi i hapur dhe përdorimi i preparateve kimike të rrezikshme për ujin, të cilat shfrytëzohen për mbrojtjen dhe rritjen e bimëve dhe për shkatërrimin e barojave;
- 2.9. ndërtimi dhe puna e fermave të kafshëve dhe shpezëve, nëse nuk janë ndërmarrë masa të veçanta me të cilat pengohet ndotja e ujërave nëntokësore;
- 2.10. eksploatimi i lëndëve minerale, përveç nëse vërtetohet që me atë aktivitet nuk rrezikohet kualiteti i ujit nëntokësor në burim;
- 2.11. eksploatimi i zhavorrit përveç seperacioneve, posaçërisht të kontrolluara dhe të mbrojtura;
- 2.12. ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i atyre ekzistuese;
- 2.13. aktivitetet tjera për të cilat vërtetohet se mund të kenë pasoja negative për burimin ujor.

Neni 13

Masat mbrojtëse në zonën e I-rë dhe të II-të

1. Vendosja e sistemit efikas të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të mbeturinave;
2. Vendosja e sistemi efikas për monitorimin e burimeve ujore nëntokësore - " Lagje Fidanishte 1,2,3-Topallnica 1,2,3" në Suharekë, Komuna e Suharekës.
 - 2.1. Si masë afat shkurtër të bëhet monitorimi i posaçëm në zonën e I-rë, të burimeve ujore nëntokësore - " Lagje Fidanishte 1,2,3-Topallnica 1,2,3" në Suharekë, Komuna e Suharekës;
 - 2.2. Si masë afatgjatë të bëhen investime të mëtejme në impiantin e trajtimit të ujit për pije deri në arritjen e rezultateve të duhura të cilësisë së ujit sipas standardeve në fuqi;
3. Për t'u pajisur me Pëlqim Mjedisor sipas nenit 7, të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, ose me Autorizim Mjedisor nga Ministria, sipas nenit 33, të Ligjit Për Mbrojtjen e Mjedisit, procedurës administrative i nënshtrohen:
 - 3.1. Ndërtimet e objekteve të reja sipas Ligjit për Ndërtim, Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe akteve tjera ligjore në fuqi;
 - 3.2. Ndërtimet pa leje, që nënkupton objektet e ndërtuara në kundërshtim me dispozitat dhe procedurat e përcaktuara sipas Ligjit për Ndërtim dhe akteve tjera ligjore në fuqi;
 - 3.3. Investimet dhe zhvillimet e projekteve me potencial ndotës të burimit të ujit;
 - 3.4. Objektet afariste të cilat nuk kanë leje për punë.
4. Për objektet ekzistuese të bëhet legalizimi i ndërtimeve pa leje, sipas ligjeve në fuqi;
5. Investitori, sipas Ligjit në fuqi, nuk mund të marrë leje për ndërtim si dhe nuk mund të fillojë realizimin e ndonjë projekti të planifikuar, pa u pajisur me Pëlqim Mjedisor ose me Autorizim Mjedisor nga MMPH-ja;

6. MMPH-ja sipas Ligjit në fuqi lëshon vërtetim për objektet që nuk i nënshtrohen procedurës administrative për t'u pajisur, me Pëlqim Mjedisor ose me Autorizim Mjedisor;
7. Për aktivitetet bujqësore që zhvillohen në këto zona të rrezikuara nga ndikimet antropogjene, hartohet programi i masave dhe zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi, Direktivës 91/676/EEC ,dhe Kodit për Praktika të Mira Bujqësore.
8. Në zonën mbrojtëse të burimit ndalohet transporti i mallrave të rrezikshme sipas Ligjit Nr. 04/L-183, PËR TRANSPORTIN TOKËSOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME.
9. Të vendosen tabelat informative në kufirin e zonës së I-rë dhe II-të mbrojtëse;
10. MMPH-ja harton planin e veprimit për zbatimin e masave mbrojtëse;

Neni 14

Masat mbrojtëse në zonën e III-të

1. Për t'u pajisur me Pëlqim mjedisor ose Autorizim Mjedisor për zonën e III- të mbrojtëse, aplikohen procedurat administrative sipas nenit 13 të këtij Vendimi;
2. Për aktivitetet bujqësore, të zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi, Direktivës 91/676/EEC, dhe Kodit për Praktika të Mira Bujqësore.

Neni 15

Vendimi hyn në fuqi datën e shpalljes në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës .

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/191
Datë: 18.06.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 66 dhe 67 të Ligjit 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2014, mori:

V E N D I M

Për përcaktimin e zonave të mbrojtura ujore dhe masat e tyre mbrojtëse të burimeve ujor nëntokësor që përdoren për pije - "Pusi i Atit 1,2,3,4,5" Malësia e Re, Komuna e Suharekës

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Vendimi është, që:
 - 1.1. të mbrojë burimet ujore nëntokësore - "Pusi i Atit 1,2,3,4,5" Malësia e Re, Komuna e Suharekës, nga ndikimet negative, të cilat mund ta dëmtojnë gjendjen normale dhe të qëndrueshme të ujit nga aspekti i cilësisë dhe sasisë;
 - 1.2. të sigurojë zhvillim dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve të ujit për pije nga burimet ujore nëntokësore - "Pusi i Atit 1,2,3,4,5" Malësia e Re, Komuna e Suharekës, i cili është i domosdoshëm për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social- ekonomik të Kosovës;
 - 1.3. të përcaktojë zonat e mbrojtjes së burimeve ujore nëntokësore - "Pusi i Atit 1,2,3,4,5" Malësia e Re, Komuna e Suharekës, si dhe masat e tyre mbrojtëse sipas Ligjit në fuqi.
2. Politikat e mbrojtjes së ujërave bazohen edhe në rritjen e nivelit të mbrojtjes së resursit ujor.

3. Ky Vendim ka për bazë rezultatet e kontrollit të posaçëm dhe studimit kryesor para ndërtimit të burimit ujqor, sipas nenit 38, të Udhëzimit Administrativ "Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Ujqore dhe Masat e tyre Mbrojtëse për Burimet e Ujqit që Përdoret për Pije" (Nr. 40/07).

Neni 2

Burimet ujqore nëntokësore - "Pusi i Atit 1,2,3,4,5" Malësia e Re, Komuna e Suharekës, i përkasin llojit të burimit ujqor nëntokësor - burim në aquifer intergranular.

Neni 3

Mbrojtja e burimeve ujqore nëntokësore - "Pusi i Atit 1,2,3,4,5" Malësia e Re, Komuna e Suharekës, është me interes publik dhe personat juridikë ose fizikë kanë përparësi në masat dhe procedurat që ndërmerren në zonën e mbrojtur të burimeve ujqore nëntokësore - "Pusi i Atit 1,2,3,4,5" Malësia e Re, Komuna e Suharekës.

Neni 4

Zonat e mbrojtura përfshijnë hapësirën nga burimi intergranular deri te ujëndarësi hidro-gjeologjik i burimit, si dhe objektet me pajisjet për marrjen e ujqit.

Neni 5

Kur rrezikohen kushtet cilësore në zonat e mbrojtura ujqore, sipas ligjeve në fuqi, Direktivës 91/676/EEC, dhe Kodit për Praktika të Mira Bujqësore, shpallet zonë e rrezikuar dhe mund të ndalohen ose kufizohen aktivitetet e pronarëve të tokave.

Neni 6

1. Zonat e mbrojtura të burimeve ujqore nëntokësore "Pusi im Atit 1,2,3,4,5" Malësia e Re, Komuna e Suharekës ndahen në:
 - 1.1. zona e I-rë mbrojtëse;
 - 1.2. zona e II-të mbrojtëse;
 - 1.3. zona e III-të mbrojtëse .

Neni 7

Mbikëqyrja

Mbikëqyrjen e zonave të mbrojtura dhe zbatimin e masave mbrojtëse, do ta bëjë Ministria.

Neni 8

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Shtojca - harta topografike në përpjesëtim 1:25000, ku janë të paraqitura hapësirat e zonave të mbrojtura ujqore me kufijtë e tyre të shënuar dhe të arkivuar në Ministri/Departamenti i Ujqërave/.

Neni 9

1. KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" Sha- Prizren, është përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi dhe mirëmbajtjen e zonës së I-rë dhe të II-të, rreth burimeve ujore nëntokësor - "Pusi i Atit 1,2,3,4,5" Malësia e Re, Komuna e Suharekës.
2. KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" Sha- Prizren harton Raportin vjetor për Ministrinë.

Neni 10

Zona e I-rë - zonë e mbrojtjes së regjimit të rreptë

1. Zona e I-rë mbrojtëse përfshin hapësirën, vijën e cila duhet të jetë e larguar më së paku 10m, nga objekti për marrjen e ujit, me kusht që me punime hulumtuese përkatëse dhe llogaritje të argumentohet që nuk do të vjen deri te ndotja bakteriologjike e ujit;
2. Në zonën e I-rë mbrojtëse do të rrethohen: objektet për marrjen e ujit, rezervuarët, stacionet e pompimit, trafostacionet, objektet administrative, rrugët hyrëse dhe ato të brendshme si dhe objektet tjera të cilat janë të rëndësishme për punën e objektit për furnizim me ujë;
3. Në territorin e zonës së I-rë mbrojtëse ndalohen të gjitha aktivitetet të cilat nuk janë direkt të lidhura me punën dhe mirëmbajtjen e sistemit për furnizim me ujë. Aktivitetet të cilat bëhen me qëllim të punës dhe mirëmbajtjes së sistemit për furnizim me ujë, nuk duhet të ndikojnë negativisht në burimin ujq;
4. Përjashtimisht nga paragrafi 3, i këtij neni, lejohen aktivitetet si vijon:
 - 4.1. kultivimi i barit pa përdorimin e plehrave dhe preparateve tjera kimike;
 - 4.2. shtrirja e kanalizimit dhe instalimeve tjera, të cilat shërbejnë për punën e objekteve për furnizim me ujë, me ç'rast me projektin përkatës dhe zgjidhjet ekzekutuese duhet të sigurohet që ato instalime të mos e rrezikojnë burimin ujq nëntokësor.

Neni 11

Zona e II-të - zonë e mbrojtjes së regjimit të kufizuar

1. Zona e II-të mbrojtëse përfshin hapësirën nga kufiri i jashtëm i zonës së I-rë mbrojtëse deri te vija prej së cilës ujit nëntokësor i nevojitet më së paku 50 ditë për arritje gjer në objektin për marrjen e ujit.
2. Në territorin e zonës së II-të mbrojtëse të burimit në aquifer intergranular, është e ndaluar ndërtimi i objekteve dhe kryerja e aktiviteteve të cilat mund të ndotin ujin e burimit, e veçanërisht:
 - 2.1. ndërtimi i vendbanimeve të reja dhe ndërtimi i kanalizimeve, përveç nëse jo ujë lëshueshmëria e gypave të kanalizimit është e kontrolluar dhe e siguruar;
 - 2.2. ndërtimi i objekteve sportive dhe rekreative pa kanalizim jo ujëlëshues;

- 2.3. ndërtimi dhe eksploatimi i burimeve dhe puseve të cilat nuk shfrytëzohen për furnizim publik;
- 2.4. grumbullimi dhe deponimi i të gjitha llojeve të mbeturinave;
- 2.5. ndërtimi dhe puna e stacioneve hekurudhore, të autobusëve dhe terminaleve, nëse nuk janë ndërmarrë masa të posaçme me të cilat pengohet ndotja e burimit ujor nëntokësor;
- 2.6. ndërtimi dhe përdorimi i depove të materieve të rrezikshme për ujin;
- 2.7. gjurmimet në akuifer, përveç në periudhë të shkurtër dhe nën kontrollin e cilësisë së ujërave nëntokësorë;
- 2.8. ndërtimi i fermave të kafshëve dhe shpezëve, përveç rritjes deri në 10 krerë bagëti të mëdha dhe shpezë në amvisëritë individuale për nevoja personale, nëse ka të ndërtuar dhe mirë në funksion kanalizimin jo ujëlëshues, gjegjësisht gropën septike jo ujë përshkuese;
- 2.9. transportimi rrugor i kemikaljeve, lëndëve djegëse të lëngëta, vajrave dhe materieve tjera të rrezikshme sipas ligjeve në fuqi;
- 2.10. mihja dhe aktivitete ndërtimi që do të dobësonin shtresat gjeologjike mbrojtëse;
- 2.11. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura në akuifer, si dhe ujërave të ndotura të pa trajtuara në tokë, përfshirë edhe zbrazjen e automjeteve për pastrimin dhe bartjen e fekaleve;
- 2.12. ndërtimi dhe puna e reparteve industriale dhe zejeve të cilat mund të lëshojnë materie të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin;
- 2.13. ndërtimi dhe puna e pajisjeve për pastrimin e ujërave të ndotura dhe pajisjeve për ndezjen e mbeturinave të ngurta;
- 2.14. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura të trajtuara në tokë;
- 2.15. ndërtimi dhe eksploatimi i gyp sjellësit për transportin e kemikateve, lëndëve djegëse të lëngëta, vajrave dhe lëngjeve tjera të rrezikshme, nëse nuk janë ndërmarrë masa të posaçme me të cilat pengohet infiltrimi i këtyre lëngjeve në ujërat nëntokësorë;
- 2.16. kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz dhe materie tjera të rrezikshme, si dhe për ujërat minerale, nëse nuk janë ndërmarrë masa të veçanta me të cilat pengohet infiltrimi ose rrjedhja e këtyre materieve në ujërat nëntokësorë;
- 2.17. deponimi i hapur dhe përdorimi i preparateve kimike të rrezikshme për ujin, të cilat shfrytëzohen për mbrojtjen dhe rritjen e bimëve dhe për shkatërrimin e barojave të dëmshme;

- 2.18. ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i atyre ekzistuese;
- 2.19. eksploatimi i lëndëve minerale, përveç nëse vërtetohet që me atë aktivitet nuk rrezikohet kualiteti i ujit nëntokësor në burim; dhe
- 2.20. aktivitetet tjera për të cilat vërtetohet se mund të ketë pasoja negative kompleksi i burimeve ujore nëntokësore.

Neni 12

Zona e III-të mbrojtëse - zona e mbrojtjes së regjimit të lehtë

1. Territori i zonës së III-të mbrojtëse përfshinë hapësirën nga kufiri i jashtëm i zonës së II-të mbrojtëse deri te ujëndarësi hidro gjeologjik, të përcaktuar në kushtet e eksploatimit të burimit ujor që paraqet kufirin e jashtëm të zonës së III-të mbrojtëse.
2. Në territorin e zonës së III-të mbrojtëse, ndalohet ekzekutimi i punimeve, ndërtimi i objekteve dhe kryerja e aktiviteteve me të cilat mund të ndotin ujin e burimit, e veçanërisht:
 - 2.1. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura të pa trajtuara në aquifer, si dhe ujërave të ndotura të pa trajtuara në tokë, përfshirë edhe zbrazjen e automjeteve për pastrimin dhe bartjen e fekaleve;
 - 2.2. ndërtimi dhe puna e reparteve industriale dhe aktiviteteve të cilat mund të lëshojnë materie të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin;
 - 2.3. transporti rrugor i materieve të rrezikshme sipas Ligjit në fuqi;
 - 2.4. ndërtimi dhe puna e pajisjeve për pastrimin e ujërave të ndotura dhe pajisjeve për ndezjen e mbeturinave të ngurta;
 - 2.5. shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura të trajtuara në tokë;
 - 2.6. ndërtimi dhe eksploatimi i gyp sjellësit për transportin e kemikateve, lëndëve djegëse të lëngëta, vajrave dhe lëngjeve tjera të rrezikshme, nëse nuk janë ndërmarrë masa të posaçme me të cilat pengohet infiltrimi i këtyre lëngjeve në ujërat nëntokësorë;
 - 2.7. kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz dhe materie tjera të rrezikshme, si dhe për ujërat minerale, nëse nuk janë ndërmarrë masa të veçanta me të cilat pengohet infiltrimi ose rrjedhja e këtyre materieve në ujërat nëntokësorë;
 - 2.8. deponimi i hapur dhe përdorimi i preparateve kimike të rrezikshme për ujin të cilat shfrytëzohen për mbrojtjen dhe rritjen e bimëve dhe për shkatërrimin e barojave;

- 2.9. ndërtimi dhe puna e fermave të kafshëve dhe shpezëve, nëse nuk janë ndërmarrë masa të veçanta me të cilat pengohet ndotja e ujërave nëntokësore;
- 2.10. eksploatimi i lëndëve minerale, përveç nëse vërtetohet që me atë aktivitet nuk rrezikohet kualiteti i ujit nëntokësor në burim;
- 2.11. eksploatimi i zhavorrit përveç seperacionet, posaçërisht të kontrolluara dhe të mbrojtura;
- 2.12. ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i atyre ekzistuese;
- 2.13. aktivitetet tjera për të cilat vërtetohet se mund të ketë pasoja negative burimi ujqor.

Neni 13

Masat mbrojtëse në zonën e I-rë dhe të II-të

1. Vendosja e sistemit efikas të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të mbeturinave;
2. Vendosja e sistemit efikas për monitorimin e burimeve ujore nëntokësore - "Pusi i Atit 1,2,3,4,5" Malësia e Re, Komuna e Suharekës;
 - 2.1. Si masë afat shkurtër të bëhet monitorim i posaçëm në zonën e I-rë të burimeve ujore nëntokësore - "Pusi i Atit 1,2,3,4,5" Malësia e Re, Komuna e Suharekës;
 - 2.2. Si masë afatgjatë të bëhen investime të mëtejme në impiantin e trajtimit të ujit për pije deri në arritjen e rezultateve të duhura të cilësisë së ujit sipas standardeve në fuqi;
3. Për t'u pajisur me Pëlqim Mjedisor sipas nenit 7, të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, ose me Autorizim Mjedisor nga Ministria, sipas nenit 33, të Ligjit Për Mbrojtjen e Mjedisit, procedurës administrative i nënshtrohen:
 - 3.1. Ndërtimet e objekteve të reja sipas Ligjit për Ndërtim, Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe akteve tjera nënligjore në fuqi;
 - 3.2. Ndërtimet pa leje, që nënkuptohen objektet e ndërtuara në kundërshtim me dispozitat dhe procedurat e përcaktuara sipas Ligjit për Ndërtim dhe akteve tjera ligjore në fuqi;
 - 3.3. Investimet dhe zhvillimet e projekteve me potencial ndotës të burimit të ujit;
 - 3.4. Objektet afariste të cilat nuk kanë leje për punë.
4. Për objektet ekzistuese të bëhet legalizimi i ndërtimeve pa leje, sipas Ligjeve në fuqi;
5. Investitori, sipas Ligjit në fuqi, nuk mund të marrë leje për ndërtim si dhe nuk mund të fillojë realizimin e ndonjë projekti të planifikuar, pa u pajisur me Pëlqim Mjedisor ose me Autorizim Mjedisor nga MMPH-ja;
6. MMPH-ja sipas Ligjit në fuqi, lëshon vërtetim për objektet që nuk i nënshtrohen procedurës administrative për t'u pajisur, me Pëlqim Mjedisor ose me Autorizim Mjedisor;

7. Për aktivitetet bujqësore që zhvillohen në këto zona të rrezikuara nga ndikimet antropogjene, hartohet programi i masave dhe zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi, Direktivës 91/676/EEC dhe Kodit për Praktika të Mira Bujqësore.
8. Në zonën mbrojtëse të burimit ndalohet transporti i mallrave të rrezikshme sipas nenit 1. të Ligjit Nr. 04/L-183 PËR TRANSPORTIN TOKËSOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME.
9. Të vendosen tabelat informative në kufirin e zonës së I-rë dhe II-të mbrojtëse;
10. MMPH-ja harton planin e veprimit për zbatimin e masave mbrojtëse.

Neni 14

Masat mbrojtëse në zonën e III-të

1. Për t'u pajisur me Pëlqim Mjedisor ose Autorizim Mjedisor për zonën e III-të mbrojtëse, aplikohen procedurat administrative sipas nenit 13, të këtij Vendimi;
2. Për aktivitetet bujqësore, të zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi, Direktivës 91/676/EEC dhe Kodit për Praktika të Mira Bujqësore.

Neni 15

Vendimi hyn në fuqi datën e shpalljes në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/191
Datë: 18.06.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2014, mori:

V E N D I M

1. Z. Mursel Racaj, emërohet Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë Qendrore të Prokurimit, në kuadër të Ministrisë së Financave.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë